



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më .10.2024

MBLEDHJA Nr. 40,
Datë 23.10.2024, ora 11:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Mërkurë, datë 23.10.2024, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 40 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbal-it të mbledhjes së Bordit të ERE-s më datë 14.10.2024.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “PARISOL” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “ALBESP TRADING & CONSULTING” shpk për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “HYDROPOWERPLANT CONSTRUCTION” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve të paluajtshme të saj.
5. Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 132, , datë 02.07.2024, “Mbi licencimin e shoqërisë “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”.
6. Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s 16, datë 23.01.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë “DIEZELA” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Ljusa”, me kapacitet të instaluar 1980 kW”, i ndryshuar.
7. Informacion shtesë mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e disa ndryshimeve në rregullat e tregut të energjisë elektrike, të miratuara me vendimin e bordit të ERE nr. 347, datë 27.12.2022, i ndryshuar
8. Çështje të tjera

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI